

MASAT REPRESIVE PËR MBROJTJEN E GRAVE

(Analizë e Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale)



Prishtinë, nëntor 2022

Autor: Gzim Shala

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj dhe Betim Musliu

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë për Çështje të Narkotikëve Ndërkombëtarë dhe Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Ilaz Agushi
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

Përkrahur nga:

Nëntor 2022
Prishtinë, Republika e Kosovës



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive.....	4
2. Miratimi i Projektligjit Penal dhe të Procedurës Penale.....	5
3. Qasja represive ndaj të dënuarve	5
4. Kundër efekti i publikimit të aktgjykimit	7
5. Zbutja e dënimit.....	8
6. Dhuna ndaj grave në jetën publike	9
7. Favorizimi i të pandehurve përmes afatit të hetimeve.....	10
8. Paraburgimi	11
9. Afatet e gjykimit.....	12

1. Përmbledhje ekzekutive

Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, ka iniciuar në Kuvend Projektligjet për Ndryshimin e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale. Këto Projektligje, ndër të tjera, kanë për synim përcaktimin e dispozitave për ngritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në luftimin e veprave penale të dhunimit, sulmit seksual dhe dhunës në familje. Përkundër qëllimit tejet legjitim për të luftuar këto dukuri serioze kriminale, IKD gjen se Ministria e Drejtësisë dhe Qeveria nuk kanë ndjekur rrugën adekuate për ta bërë këtë. Kjo pasi IKD gjen se të dy këto Projektligje shoqërohen me shkelje të Kushtetutës, Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Po ashtu, IKD gjen se këto Projektligje janë në kundërshtim me disa prej parimeve bazë të drejtësisë penale. Në disa raste, IKD ka gjetur se këto dispozita janë në kundërshtim edhe me interesat e viktimave, të cilat interesa synohet të avancohen përmes këtyre Projektligjeve.

Përcaktimi i Projektligjit të Procedurës Penale se në të gjitha rastet e dhunimit dhe dhunës në familje duhet të caktohet paraburgimi nga gjykata është në kundërshtim me Kushtetutën, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo krijon potencial të lartë të keqpërdorimit përmes raportimeve të pavërteta, madje edhe ndaj grave, mbrojtja e të cilave synohet përmes këtyre Projektligjeve.

Projektligjet kanë përcaktuar se në rastet e dhunimit dhe dhunës në familje aplikohen dënime plotësuese të cilat nuk janë në harmoni me synimet e dënimeve plotësuese. Përmes dënimeve plotësuese si ndalimi i blerjes në ankande, aplikimit si investitor strategjik, punësimit në sektorin publik dhe drejtimit të automjetit, Projektligjet kanë ndjekur një qasje represive ndaj të dënuarve për këto raste, e cila qasje nuk njihet në të drejtën penale bashkëkohore. Kjo qasje represive është në kundërshtim me qëllimet e dënimit. Përmes këtyre dënimeve, rritet potenciali për recidivizëm, potencial ky i kundërt me qëllimet e dënimit.

IKD gjen se publikimi i aktgjykimeve në rastet e dhunës në familje krijon kundër efekt për viktimat e dhunës në familje. Veçanërisht në një shoqëri të vogël si Kosova, viktimat e dhunës në familje dhe fëmijët lehtësisht mund të identifikohen. Shkelja e konfidencialitetit në këtë rast shkon në kundërshtim me interesat e viktimave të dhunës në familje. Po ashtu, si dispozitë e cila paraqet dëmtim të interesave të viktimave të dhunës në familje është edhe shkurtimi i afateve të hetimit të këtyre rasteve.

Sa i përket dhunës ndaj grave në jetën publike, IKD ka gjetur se kjo dispozitë është në kundërshtim me barazinë para ligjit, për shkak se gjinia e viktimës konsiderohet element i veprës penale. Ky inkriminim mund të krijojë probleme në ushtrimin e të drejtës për të protestuar në raste të caktuara me interes publik, përderisa nuk është e përcaktuar se çfarë nënkuptohet me “dhunë fizike, psikologjike, seksuale, ekonomike”. Duhet theksuar faktin se inkriminimi i kësaj vepre penale nuk është çështje e njohur në vendet evropiane. Ky lloj inkriminimi, gjenezën e ka në shtetet e Amerikës Latine, ku Bolivia ka qenë shteti i parë që në vitin 2012 e ka inkriminuar këtë vepër penale. Edhe konteksti i këtyre shteteve, është i ndryshëm nga rasti i Kosovës dhe kështu nuk legjitimohet ky lloj inkriminimi.

2. Miratimi i Projektligjit Penal dhe të Procedurës Penale

Me 12 tetor 2022, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar Projektligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kodit Nr. 06/L074 Penal i Republikës së Kosovës (Tutje: Projektligji Penal) dhe Projektligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kodit Nr. 08/L032 të Procedurës Penale (Tutje: Projektligji i Procedurës Penale). Këto dy Projektligje kanë përcaktuar dispozita që kanë të bëjnë me veprat penale kundër integritetit seksual, veprat penale kundër martesës dhe familjes dhe krimet kibernetike. Këto të fundit, nuk janë objekt i kësaj analize. Sa i përket Kodit të Procedurës Penale, duhet theksuar se Kodi i ri i Procedurës Penale ende nuk ka hyrë në fuqi. Kështu, ndryshimet mbi këtë kod janë duke u proceduar para se i njëjti të hyjë në fuqi.

Duke i konsideruar çështjet të cilat trajtohen në këto dy Projektligje si urgjente, Ministria e Drejtësisë nuk ka zhvilluar fare proces të konsultimit publik. Kështu, Ministria e Drejtësisë ka vepruar në kundërshtim me Rregulloren për Standardet Minimale në Procesin e Konsultimit Publik, e cila lejon përjashtimin e konsultimit publik vetëm në rastet e emergjencave shtetërore dhe rastet e përcaktuara me ligj¹. Përtej kësaj shkelje, me këtë qasje, Ministria e Drejtësisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e Konventës së Stambollit, e cila kërkon ndërmarrje të masave gjithëpërfshirëse dhe të bashkërenduara².

Në memorandumet shpjeguese të dy Projektligjeve, thuhet fjalia e njëjtë se: “Projektligji është produkt i një analize të brendshme dhe të mirëfilltë, krahas numrit të madh të veprave penale me theks të veçantë veprave penale të Dhunimit, Dhunës në Familje dhe Krimeve Kibernetike”³. Përballë kësaj fjalie, që jep përshtypjen se është një fjali “copy-paste”, Ministria e Drejtësisë nuk ka prezantuar ndonjë “analizë të brendshme dhe të mirëfilltë” mbi nevojën e këtyre dispozitave në luftën kundër dhunës në familje. Në kuptim të standardeve të përcaktuara nga Konventa e Stambollit, edhe këto analiza do duhej të ishin gjithëpërfshirëse.

Me 17 tetor 2022 këto Projektligje janë miratuar në parim nga komisioni parlamentar.

3. Qasja represive ndaj të dënuarve

Sipas Projektligjit Penal, për veprën penale të dhunimit dhe dhunës në familje dënimet plotësuese janë edhe:

- 1) ndalimi i blerjes në ankande të shitjes së pronave publike, aseteve publike apo licencave që jepen nga një autoritet publik në çfarëdo shërbimi nga tre (3) deri në dhjetë (10) vjet dhe

¹ Rregullorja (QRK) Nr. 05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik, neni 16 dhe Rregullorja Nr. 09/2011 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, neni 33.

² Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, neni 7.

³ Memorandum Shpjegues për Projektligji për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale, Ministria e Drejtësisë, faqe 6 dhe Memorandum Shpjegues për Projektligji për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kodit Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, Ministria e Drejtësisë, faqe 7.

- 2) ndalimi i aplikimit si investitor strategjik dhe çdo formë tjetër e përfitimit nga privilegjet që jepen nga legjislacioni në fuqi nga tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.

Ndërsa, në rastet e dhunimeve, dënime të tjera plotësuese janë edhe:

- 1) Ndalimi i punësimit në sektorin publik, në të gjitha nivelet dhe;
- 2) Ndalimi i së drejtës për patentë shofer dhe drejtim të automjetit;

Këto dispozita, janë qartazi në kundërshtim me qëllimin e sanksioneve penale. Sipas Ligjit, “[e]kzekutimi i sanksioneve penale ka për qëllim risocializimin dhe riintegrimin e të dënuarit në shoqëri dhe përgatitjen e tij për jetë, si dhe për sjellje të përgjegjshme...⁴”.

Fillimisht, duhet theksuar se në teorinë e së drejtës penale, shqiptimi i dënimeve plotësuese bëhet për dy arsye. Arsyeja e parë ndërlidhet me rastet kur dënimi i shqiptuar e bënë të papërshtatshëm një person për të ushtruar një detyrë të caktuar e cila kërkon një integritet përtej risocializimit. Arsyeja e dytë ka të bëjë me qëllimin për parandalimin e recidivizmit. Kjo pasi personi i dënuar nuk duhet që menjëherë pas mbajtjes së dënimit të vendoset në situatën dhe rrethanat e njëjta në të cilat ka kryer veprën penale⁵.

Të katër dënimet plotësuese të listuara më lartë, janë dënime jashtë kontekstit të kryerjes së veprave penale, për shkak të së cilave shqiptohet dënimi plotësues. Nuk mund të thuhet se blerja në ankande publike, aplikimi si investitor strategjik apo drejtimi i automjetit kërkojnë domosdoshmërisht persona me nivel aq të lartë të integritetit që shkon përtej risocializimit të personit të dënuar. Në anën tjetër, të tri këto dënime plotësuese, nuk ndërlidhen me rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, që të synojë parandalimi i recidivizmit. Kështu, në linjë me kuptimin e dënimeve plotësuese, këto dënime janë jashtë kontekstit.

I tillë është edhe ndalimi i punësimit të sektorit publik në rastet kur personi dënohet për dhunim. Sipas Projektligjit Penal, secili person i dënuar për dhunim, do ta humbë përjetësisht të drejtën për tu punësuar në sektorin publik, në çfarëdo niveli. Sipas Projektligjit Penal, këtu nuk janë të rëndësishme rrethanat: mjafton që personi të jetë i dënuar për dhunim.

Serioziteti i veprës penale të dhunimit nuk duhet të arsyetojë dënime jashtë kontekstit të veprës penale, pasi vet ligji përmes inkriminimit të dënimit bazik ka shprehur gjykimin e vet. Në lidhje me këtë, duhet të theksojnë se sipas ligjit, dënimi në rastet e dhunimit, varësisht nga forma e kryerjes, shkon deri në 25 vite burgim.⁶ Varësisht rrethanave në të cilat është kryer vepra penale, shqiptohet edhe dënimi, i cili synon që të arrijë qëllimet e dënimit, një ndër të cilat është që “të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij”.⁷ Sipas Ligjit, gjatë periudhës kur i njëjti është në vuajtje të dënimit, synohet

⁴ Ligji Nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 5.

⁵ Prof. Dr. Ismet Salihu, Mr.Sc. Hilmi Zhitija dhe Dr.Sc. Fejzullah Hasani, “Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës”, Prishtinë, 2014, faqe 235-236.

⁶ Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, neni 227.

⁷ Po aty, neni 38.

që i njëjti të risocializohet dhe të riintegrohet në shoqëri⁸. Për më tepër, personi i cili tanimë ka vuajtur dënimin, i ofrohet edhe ndihma pas lirit nga dënimi⁹.

Ndalimi ex lege i të gjithë personave të dënuar për dhunim që të punësohen në institucionet publike bie qartazi në kundërshtim me këto qëllime të dënimit dhe ekzekutimit të sanksioneve penale. Nëse thuhet se secili person i dënuar për dhunim, e i cili e ka mbajtur dënimin, është ende i papërshtatshëm për të punuar në sektorin publik, atëherë zhvlerësohet sanksioni i shqiptuar nga gjykata si dhe ekzekutimi i atij sanksioni, qëllimi i të cilave është, ndër të tjera, risocializimi dhe riintegrimi i të dënuarve. Nisur nga fakti se ky dënim plotësues nuk është i afatizuar, shqiptohet në secilin rast, nuk bëhet ndërlidhja me papërshtatshmërinë e matshme të personit të dënuar për të punuar në institucionet publike si dhe nuk ka të bëjë me rrethanat në të cilat është kryer vepra penale. Ky dënim është jashtë konceptit të dënimeve plotësuese si dhe i njëjti qartazi ka karakter represiv. Karakteri represiv i dënimeve, nuk njihet në të drejtën penale moderne.

Në fakt, po këto lloj dënimesh do të jenë shtysë për recidivizëm. Përderisa personi i cili tanimë ka vuajtur dënimin nuk ka mundësi të punësohet në sektorin publik, nuk ka të drejtë të ngasë automjetin, të marrë licenca e të tjera, praktikisht i njëjti do të jetë jashtë shoqërisë dhe i paaftë për të ndërtuar një jetë normale. Kjo qasje, në një periudhë të vështirë si periudha post-penale, do ta shtyjë të njëjtin që të futet në vepra penale. Kështu, këto lloj dënimesh do ta arrijnë qëllimin e kundërt që duhet ta kenë dënimet plotësuese.

4. Kundër efekti i publikimit të aktgjykimit

Sipas Projektligjit Penal [neni 6], “Gjykata urdhëron publikimin e aktgjykimit për personin që është shpallur fajtor për veprën penale të dhunimit, sulmit seksual si dhe dhunës në familje”. Publikimi i aktgjykimeve në rastet e dhunës në familje ka kundër efekt në raport me interesat e viktimave të dhunës në familje dhe fëmijëve.

Mbrojtja e interesave të fëmijëve dhe mbrojtja e të dëmtuarve është njëra prej arsyeve ligjore se kur mund të mbyllet seanca e shqyrtimit gjyqësor¹⁰. Kështu, publikimi obligativ i aktgjykimit në rastet e dhunës në familje, bie në kontradiktë me mundësinë e gjyqtarit që gjatë procedurës penale të mbyll shqyrtimin gjyqësor për publikun.

Konfidencialiteti i masave është një prej parimeve kryesore në luftimin e dhunës në familje. Në kuptim të këtij parimi, masat në këtë fushë duhet të dizajnohen në atë mënyrë që të mbrojnë identitetin e viktimës nga shtypi dhe publiku¹¹. Publikimi i aktgjykimit qartazi e tregon identitetin e viktimës edhe nëse të dhënat mbi identitetin e viktimës në aktgjykim

⁸ Ligji Nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 5.

⁹ Po aty, neni 129.

¹⁰ Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale, neni 298.1.

¹¹ “*Preventing and Combating Domestic Violence against Women*”, Council of Europe, 2016, faqe 66.

anonimizohen. Kjo ndodhë, veçanërisht, në një shoqëri të vogël si Kosova, ku përmes dhunuesit mund të identifikohen edhe viktimat dhe fëmijët.

Kështu, publikimi i aktgjykimit në rastet e dhunës në familje, duke mos marrë parasysh interesat e viktimës së dhunës në familje dhe fëmijëve, është masë e cila afekton paarsyeshëm këta të fundit. Kështu, ky dënim plotësues, nuk afekton vetëm të dënuarin për dhunë në familje, por edhe viktimat e dhunës në familje, nën vullnetin e të cilëve duhet të jetë publikimi ose jo i rrethanave të tyre familjare.

5. Zbutja e dënimit

Me rastin e matjes së dënimit, rrethanat lehtësuese dhe rënduese ndikojnë për përcaktimin e lartësisë së dënimit brenda limiteve të përcaktuara me ligj. Por, në praktikë, mund të ketë raste të cilat kryhen në rrethana posaçërisht lehtësuese. Në këtë situatë, edhe shqiptimi i dënimit në minimumin ligjor nuk është në interes të drejtësisë. Për këtë arsye, kërkohet që për këto raste përjashtimore të cilat mund të hasen në praktikë, të parashihen edhe dispozita të cilat lejojnë zbutjen e dënimit nën minimumin e përcaktuar me ligj. Si rregull, këto dispozita aplikohen në rastet e të gjitha natyrave, kur konstatohet se ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese që e arsyetojnë zbutjen e dënimit nën minimumin e përcaktuar me ligj¹². Dispozita të tilla aplikohen në shumicën e kodeve penale¹³.

Në linjë me këtë, Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës [neni 71 dhe 72] ka përcaktuar rastet kur mund të shqiptohet dënimi nën minimumin e përcaktuar me ligj dhe kufijtë e zbutjes së dënimit. Sipas këtij Kodi, gjykata mund të bëjë zbutjen e dënimit në rastet kur parashihet me ligj, kur ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese dhe në rastet kur kryesi pranon fajësinë ose ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë. Nuk ka një listë të rasteve se kur mund të aplikohen këto dispozita. Kjo pasi rrethana të tilla mund të parashihen në secilën vepër penale. Përkatësisht, secila vepër penale mund të kryhet në rrethana posaçërisht lehtësuese, të cilat e justifikojnë uljen e dënimit nën minimumin e përcaktuar me ligj. Siç u tha, kjo rregull mundëson ndjekjen e interesit të drejtësisë përtej përcaktimit strikt të përcaktuar me ligj.

Sipas Projektligjit Penal, këto dispozita nuk do të aplikohen në rastet e 1) Dhunimit, 2) Sulmit Seksual dhe 3) Dhunës në Familje. Kjo zgjidhje ligjore është në kundërshtim me rregullat bazë të matjes së një dënimi penal. Përjashtimi i këtyre dispozitave në këto raste është qasje diskriminuese. Kjo pasi dispozitat që kanë të bëjnë me zbutjen e dënimit, nëse ekzistojnë rrethanat, do të mund të aplikohen edhe në rastet më të rënda penale, si vrasja e rëndë, gjenocidi e të tjera, derisa nuk do të aplikohen në rastet e dhunimit, sulmit seksual dhe dhunës në familje.

¹² Prof. Dr. Ismet Salihu, Mr.Sc. Hilmi Zhitija dhe Dr.Sc. Fejzullah Hasani, "Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës", Prishtinë, 2014, faqe 264-265.

¹³ Shih psh: Kodi Penal i Gjermanisë, neni 49, Kodi Penal i Norvegjisë, neni 80, Kodi Penal i Portugalisë, neni 72 etj.

Në anën tjetër, duhet theksuar se përjashtimi i këtyre dispozitave nuk nënkupton ashpërsim të dënimeve. Kjo pasi ashpërsimi i dënimeve bëhet duke ngritur maksimumin e dënimit të veprës penale. Kjo do të reflektonte edhe limitet e zbutjes së dënimit. Por, përjashtimi i këtyre dispozitave i detyron gjykatat që edhe në rastet shumë përjashtuese, të cilat mund të paraqiten në praktikë, të mos mund të aplikohen këto dispozita.

Përjashtimit i aplikimit të dispozitave të zbutjes së dënimit në rastet e dhunës në familje është pothuajse i pa efekt. Kjo pasi për rastet e dhunës në familje, vet minimumi i dënimit të përcaktuar me ligj është 30 ditë burgim dhe 100 euro gjobë¹⁴. Nëse do të zbatoheshin dispozitat e zbutjes së dënimit, në rrethanat e përcaktuara me ligj, dënimi me 30 ditë burgim do të mund të zëvendësohej me gjobë derisa gjoba do të mbetej e njëjtë¹⁵. Kështu, kjo dispozitë në Projektligjin Penal është pothuajse pa efekt në raport me rastet e dhunës në familje, përderisa dënimi i përcaktuar për këtë veprë penale është minimumi i përgjithshëm.

6. Dhuna ndaj grave në jetën publike

Neni 11 i Projektligjit Penal ka përcaktuar se “Kushdo që me qëllim të frikësimit ose detyrimit për të vepruar kundër vullnetit të tyre, me dashje ushtron dhunë fizike, psikologjike, seksuale, ekonomike, në formë të drejtpërdrejtë apo indirekte, ndaj grave që ushtrojnë funksione publike ose kandidate për ushtrimin e funksioneve publike dënohet me gjobë dhe me burgim nga gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet”.

Kriminalizimi i kësaj vepre penale i ka disa probleme esenciale dhe konceptuale. Aspekti i parë është fakti se kjo dispozitë paraqet mbrojtje të pabarabartë penale për palët e dëmtuara. Kështu, subjektet të cilat mbrohen nga kjo dispozitë penale janë vetëm nga njëra gjini. Kështu nuk është situata tek dhunimi, sulmi seksual, dhuna në familje e të tjera, ku subjekte të mbrojtura janë të dy (2) gjinitë. Përcaktimi i gjinisë si element i veprës penale në këtë rast është në kundërshtim me barazinë para ligjit.

Nisur nga elementet e kësaj vepre penale, nuk kuptohet se cila është e mira e mbrojtur përmes kriminalizimit të kësaj vepre penale: detyra publike apo gratë në jetën publike. Kjo pasi “veprimi kundër vullnetit të tyre” nuk kuptohet nëse ka të bëjë me veprimin privat apo publik.

Paqartësia e kësaj norme mund të referojë në pasigurinë juridike të ushtrimit të të drejtave të tjera dhe cenimit të jetës publike në përgjithësi. Me këtë rast, duhet theksuar faktin se personat publik kanë një përgjegjësi më të madhe përballë publikut se sa personat e tjerë privat. Kjo për faktin se të njëjtit kanë pasur ose kanë autorizime publike. Për çështje të caktuara publike, është e drejtë e secilit person dhe normale në demokracitë moderne edhe të protestohet ndaj zyrtarëve të caktuar publik. Këta persona publik, mund të jenë edhe gra. Kështu, ky lloj inkriminimi, mund të krijojë probleme në ushtrimin e të drejtës për të protestuar në raste të caktuara me

¹⁴ Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, neni 248, 42 dhe 43.

¹⁵ Po aty, neni 72.1.

interes publik, përderisa nuk është e përcaktuar se çfarë nënkuptohet me “dhunë fizike, psikologjike, seksuale, ekonomike”.

Duhet theksuar faktin se inkriminimi i kësaj veprë penale nuk është çështje e njohur në vendet evropiane. Ky lloj inkriminimi, gjenezën e ka në shtetet e Amerikës Latine, ku Bolivia ka qenë shteti i parë që në vitin 2012 e ka inkriminuar këtë veprë penale. Edhe konteksti i këtyre shteteve, është i ndryshëm nga rasti i Kosovës dhe kështu nuk legjitimohet ky lloj inkriminimi¹⁶.

7. Favorizimi i të pandehurve përmes afatit të hetimeve

Sipas Kodit Nr. 04/L-123 të Procedurës Penale¹⁷ [neni 159] afati i hetimeve është dy (2) vite, me mundësi vazhdimi edhe për dy vite të tjera. Me Kodin Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale, mundësia e shtyrjes së afatit të hetimeve është rritur në një vit. Sipas Ministrisë së Drejtësisë, kjo do të ndikojë në një hetim kualitativ¹⁸. Ndërsa, sipas Projektligjit të Procedurës Penale, në rastet e dhunës në familje, afati i hetimeve do të përfundojë brenda një viti.

Afati i hetimeve është aspekt i cili e mbron të pandehurin dhe jo viktimën. Kjo pasi përmes afatit të hetimeve, kufizohet e drejta e shtetit që pafundësisht ta mbajë një person të caktuar nën hetime. Kjo është edhe arsyeja se pse në rastet kur kalon afati prej dy viteve, kërkohet vendimi i gjykatës, në mënyrë që të pandehurit t’i mbrohen të drejtat. Kështu, sa më i gjatë të jetë afati i hetimeve aq më e rënduar është pozita procedurale e të pandehurit.

Kështu, Projektligji i Procedurës Penale ka shkuar në drejtim të kundërt me interesat e palëve të dëmtuara dhe ka rritur të drejtat e të pandehurve në rastet e dhunës në familje. Këtu nuk kemi të bëjmë me efikasitet procedural. Prokurori i Shtetit duhet të veprojë në mënyrë efikase dhe në momentin kur mbledh prova të mjaftueshme, nuk është i obliguar që të presë afatin prej 2 viteve që të procedojë me rastin. Por, në kuptim të Projektligjit të Procedurës Penale, Prokurori i Shtetit nuk do të ketë mundësi që të vazhdojë hetimet penale, nëse nuk ka arritur t’i përfundojë të njëjtat brenda periudhës kohore prej një viti.

Në praktikë, edhe nëse rastet e dhunës në familje trajtohen me prioritet, mund të ketë raste të ndryshme ku për arsye objektive apo subjektive hetimi nuk mund të përfundohet brenda një viti. Kështu, në rastet e dhunës në familje, hetimet përfundohen dhe i pandehuri lihet i lirë. Ndërsa, në të gjitha rastet e natyrave të tjera, Prokurori i Shtetit do të ketë mundësi që të vazhdojë hetimet deri në dy vite, me mundësi vazhdimi edhe për gjashtë muaj. Kështu, kjo zgjidhje ligjore qartazi shkon në favor të të pandehurve dhe disfavor të palëve të dëmtuara, të

¹⁶ Juliana Restrepo Sanín, “*Criminalizing Violence against Women in Politics: Innovation, Diffusion, and Transformation*”, Politics & Gender, 2020, faqe 12-14.

¹⁷ Shënim: Ky Kod është në fuqi deri më 17 shkurt 2023, kur do të hyjë në fuqi Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale.

¹⁸ “*Finalizohet puna e Grupit Punues për adresimin e çështjeve me rëndësi për Projektkodin e Procedurës Penale*”, Ministria e Drejtësisë, 18 qershor 2021. (Shih linkun <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1.15.2516>). (Qasur për herë të fundit më 9 nëntor 2022).

cilat rrezikojnë që të mos marrin drejtësi në rastet kur Prokurori i Shtetit për arsye objektive apo subjektive nuk përfundon hetimet brenda periudhës kohore prej një viti.

8. Paraburgimi

Për të siguruar praninë e të pandehurit, për pengimin e rikryerjes së veprës penale dhe për zbatimin e suksesshëm të procedurës penale, neni 171 i Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale ka listuar tetë (8) masa për sigurinë e pranisë së të pandehurit. Paraburgimi është masa më e rëndë. Sipas këtij neni, “Me rastin e vendosjes se cilën nga masat do ta zbatojë për të siguruar praninë e të pandehurit, gjykata detyrohet t’i merr parasysh kushtet e përcaktuara për masat konkrete dhe të sigurojë që të mos zbatojë masë më të rëndë kur mjafton masa e butë”.

Sipas Projektkodit të Procedurës Penale, këto dispozita nuk do të merren parasysh në rastet e dyshuara për dhunim dhe dhunë në familje. Kjo pasi Projektligji i Procedurës Penale [neni 3] e obligon gjykatën që në të gjitha rastet e tilla të shqiptojë masën e paraburgimit, duke mos lejuar shqiptimin e një mase proporcionale. Ky rregullim ligjor është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe krijon potencial të lartë për keqpërdorime të kësaj dispozite në praktikë.

Sa i përket paraburgimit, Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale ka përcaktuar kushtet të cilat duhet të plotësohen për caktimin e paraburgimit, e që janë ekzistimi i dyshimit të bazuar se është kryer një veprë penale dhe ekzistimin e rrezikut të ikjes, ndikimit në prova/dëshmitarë dhe përsëritjes/përfundimit të veprës penale. Për caktimin e masës së paraburgimit, sipas Kodit [neni 185] kërkohet mbajtja e seancës dëgjimore ku dëgjohet si Prokurori i Shtetit ashtu edhe i dyshuari. Kështu, përcaktimi i një dispozite imperative se në secilin rast që kualifikohet si dhunim apo dhunë në familje do të caktohet paraburgimi, ia humb kuptimin edhe seancës dëgjimore, e cila tanimë shndërrohet vetëm në formalitet, si dhe cenon të drejtat kushtetuese dhe ligjore të të pandehurve.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës [neni 29.1.(2)], “Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës... për **dyshim të bazuar** për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet **i domosdoshëm për të parandaluar** kryerjen e një veprë tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjykimit në mënyrën e përcaktuar me ligj”. Pra, Kushtetuta është e qartë, se caktimi i paraburgimit bëhet vetëm në bazë të rrethanave të rastin konkret, ku vlerësohet dyshimi i bazuar dhe domosdoshmëria për të parandaluar kryerjen e një veprë penale. Kështu, kjo dispozitë imperative kushtetuese, nuk lejon që për vepra penale të caktuara të parashihet caktimi automatik i paraburgimit.

Edhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut [neni 5.1.c] përcakton se “askujt nuk mund t’i hiqet liria, me përjashtim të rasteve kur, ndër të tjera, një person arrestohet ose ndalohet ligjërisht për t’u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent pas **dyshimit të arsyeshëm** se ka kryer një veprë penale ose kur çmohet në mënyrë të arsyeshme, e nevojshme për të

parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj". Sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kjo dispozitë nuk lejon aplikimin e një politike të përgjithshme të parandalimit të drejtuar kundër një individi apo një kategorie të caktuar të individëve të cilët perceptohen si të rrezikshëm apo perceptohen se kanë prirje për të kryer veprime të kundërligjshme. Sipas kësaj gjykate, kjo dispozitë nuk u ofron shteteve më shumë se sa një masë për parandalimin e një vepre specifike dhe konkrete. Në mënyrë që paraburgimi të jetë i justifikuar sipas nenit 5.1.c. të Konventës, autoritetet duhet të tregojnë bindshëm se një person i caktuar sipas të gjitha gjasave do të ishte i përfshirë në një vepër penale dhe specifike, nëse ndaj të njëjtit nuk do të caktohej paraburgimi¹⁹. Paraburgimi duhet të jetë një masë proporcionale për të arritur qëllimin²⁰.

Tutje, sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, testi i domosdoshmërisë kërkon që të merren parasysh masat e tjera më të buta se paraburgimi dhe paraburgimi duhet të shqiptohet vetëm në rastet kur gjendet se masat e tjera më të buta janë të pamjaftueshme për të mbrojtur interesin privat apo publik. Po ashtu, paraburgimi duhet të ndërpritet në momentin kur të kalojë rreziku²¹.

Në këtë mënyrë, përcaktimi i Projektligjit të Procedurës Penale se në të gjitha rastet e dhunimit dhe dhunës në familje duhet të caktohet paraburgimi nga gjykata, krahas Kushtetutës, është haptazi në kundërshtim me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kështu, ky nen është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Në anën tjetër, duhet vendosur vëmendjen tek fakti se një dispozitë e tillë krijon potencial të lartë të keqpërdorimit përmes raportimeve të pavërteta. Kjo pasi edhe në këto raste, gjykata nuk do të ketë asgjë për të vlerësuar, përderisa sipas ligjit është e obliguar që të caktojë masën e paraburgimit. Nisur nga fakti se gjinia nuk është element i veprës penale të dhunës në familje, ky keqpërdorim është edhe në raport me gratë, mbrojtja e të cilave është synim i Projektligjit të Procedurës Penale.

9. Afatet e gjykimit

Sipas Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale [neni 310], shqyrtimi gjyqësor i cili mbahet para gjyqtarit të vetëm gjykues duhet të përfundojë brenda 90 ditësh derisa shqyrtimi gjyqësor i cili mbahet para trupit gjykues duhet të përfundojë brenda 120 ditësh. Në raste të veçanta të përcaktuara me ligj, afati i shqyrtimit gjyqësor mund të shtyhet edhe për 30 ditë. Sipas Projektligjit Penal, në rastet e dhunimit dhe dhunës në familje, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundojë brenda 60 ditëve, respektivisht 90 ditëve.

¹⁹ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Rasti Kurt k. Austrisë, 15 qershor 2021, paragrafi 186 dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Rasti S., V dhe A. k. Danimarkës, 15 qershor 2021, paragrafi 89 dhe 91.

²⁰ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Rasti Ladent dhe A. k. Polonisë, 15 qershor 2021, paragrafi 55 dhe 56.

²¹ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Rasti S., V dhe A. k. Danimarkës, 15 qershor 2021, paragrafi 161.

Një problematikë në raport me shkurtimin e afateve të përfundimit të shqyrtimit gjyqësor qëndron në faktin se nuk është lejuar mundësia e zgjatjes së afatit për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor, në rrethanat e përcaktuara me ligj. Edhe në rastet e dhunimit dhe dhunës në familje mund të paraqiten situata kur rastet janë të komplikuar dhe kërkohet afat shtesë për gjykimin e tyre. Në këto situata, Projektkodi i Procedurës Penale nuk ka lënë mundësi për vazhdimin e afatit të hetimeve, e cila mundësi është e lejuar me rastin e gjykimin të të gjitha veprave të tjera penale.

Duhet theksuar faktin se në raport me këtë dispozitë, nuk paraqitet ndonjë pengesë kushtetuese apo ligjore për shkurtimin e afatit për përfundimit të shqyrtimit gjyqësor. Por, duhet theksuar faktin se ekzistimi i afateve më të shkurtra kohore, nuk garanton automatikisht efikasitet në trajtimin e rasteve penale. Gjatë monitorimit të sistemit të drejtësisë, IKD ka gjetur se përkundër faktit se afatet janë përcaktuar me ligj, në parim këto afate nuk janë respektuar²². Kështu, problemi i mungesës së efikasitetit në trajtimin e rasteve penale nuk qëndron në mungesën e kufizimeve ligjore, por mos zbatimin e këtyre kufizimeve në praktikë. Gjetjet e IKD-së dëshmojnë se kjo ndodh për shkaqe subjektive dhe objektive.

Në raport me shkaqet subjektive, Qeveria dhe Kuvendi nuk ka mandat të veprorë. Por, për të siguruar gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohor, Qeveria dhe Kuvendi mund të ndihmojnë në mënjanimin e shkaqeve objektive, duke përkrahur gjyqësorin me resurse të mjaftueshme të cilat i mundësojnë trajtimin e rasteve brenda afateve të përcaktuara me ligj. Kështu, masa më e lehtë është miratimi i dispozitave që përcaktojnë afate të shkurtra kohore për përfundimin e gjykimeve. Por, në mënyrë që këto afate të mund të zbatohen në praktikë, Qeveria dhe Kuvendi duhet të ofrojnë mbështetje financiare për këtë. Në opinionin e Departamentit të Buxhetit për Vlerësimin e Ndikimit Buxhetor, thuhet se Projektligji i Procedurës Penale nuk do të ketë kosto shtesë buxhetore²³. Kështu, përcaktimi i këtyre dispozitave në Projektligjin e Procedurës Penale nuk është shoqëruar me përkrahje financiare, në mënyrë që këto dispozita të mund të zbatohen në praktikë.

Nën këto rrethana, më e rrugës do të ishte që Projektligji i Procedurës Penale të përcaktonte se këto raste trajtohen me prioritet absolut, se sa shkurtimi i afateve të gjykimin. Duhet theksuar se përkundër faktin se në Kodin Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale përcaktohet se shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundoj brenda 90, respektivisht 120 ditëve, asgjë nuk e ndalon gjykatën që gjykimin ta përfundoj para përfundimit të këtij afati.

²² Shih Mirvet Thaqi dhe Driton Nocaj, “Drejtësia e vonuar në Kosovë”, IKD, Dhjetor, 2021.

²³ Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Opinion i Departamentit të Buxhetit për vlerësimin e ndikimit buxhetor (VNB) për Projekt Ligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kodit Nr.08/L-032 të Procedurës Penale, 14.10.2022. (Shih linkun https://kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/187deklaratabuxhetore_68sncFSXWW.pdf). (Qasur për herë të fundit më 9 nëntor 2022). faqe 2.